



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Diversiteti i metodave të gjuhës frënge

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; leksione / 40 seminare
Viti / Semestri : Viti III , Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë me perzgjedhje
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim francez.
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo është një lëndë me perzgjedhje që do të plotësojë formimin didaktik të studentit, duke e përgatitur atë gjithashtu me aspekte shumë të rëndësishme të profesionit të tij të ardhshëm si mësues i gjuhës së huaj. Kjo lëndë synon t'u vijë në ndihmë studentëve për përdorimin e metodave të gjuhës frënge në praktikën e tyre të ardhshme të mësimdhënies së gjuhës frënge në nivele të ndryshme të arsimit.

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet: Të arrijë të marrë njohuritë bazë të lëndës duke mundur të bëjë një qasje të përgjithshme të metodologjisë së cilës metoda e gjuhës frënge i përket. Të mësojë të ilustrojë parimet kryesore të metodologjisë në metodat përkatëse

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të njohë se si të:

1. dallojë tipologjinë e ushtrimeve të ndryshme gjuhësore në metodat e gjuhës frënge
2. të dallojë qartë kompetencat gjuhësore që synohen në metodat e gjuhës frënge
3. të bëjë një analizë të detajuar të aspekteve kulturore dhe gjuhësore në metodat bashkëkohore
4. të dallojë nocionin e pedagogjisë së detyrës bazuar tek Kuadri i Përbashkët Evropian i Gjuhëve dhe të ilustruar në metodat e gjuhës frënge